

**VENDIM**  
**Nr.29, datë 19.7.1997**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese :

Hilmi Dakli, Anëtar i ""

Veli Budo, Anëtar i ""

Zija Vuci, Anëtar i ""

Alfred Karamuco, Anëtar i ""

Ha1il Kopani, Anëtar i ""

Kristofor Peçi, Anëtar i ""

me sekretare Drita Filto, me datën 11.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.36 Akti që i përket:

KËRKUES:

1. PARTIA SOCIALISTE, e përfaqësuar nga Z.Bashkim Caka

2. PARTIA ALEANCA DEMOKRA TIKE, e përfaqësuar nga Z.Arben Demeti.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

**O B J E K T I:**

Shfuqizimin e vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zonat nr.73 e 74, në bazë të nenit 50 të ligjit nr.8218, datë 16.5.1997 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi përfaqësuesit e palës kërkuese, subjektin e interesuar si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

Partia Socialiste dhe Partia Aleanca Demokratike kanë kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr.1298 dhe nr.1299, datë 8.7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që kanë lënë në fuqi vendimin e komisioneve të zgjedhjeve të zonave nr.73 e 74, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të rezultatit të zgjedhjeve në këto zona dhe përsëritjen e tyre.

Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh se pretendimet për shkeljet e ligjit, janë paraqitur nga i njëjti subjekt (Partia Socialiste), dhe se Partia Aleanca Demokratike ka bërë një kërkesë për të dy zonat, vendosi që t'i shqyrtojë ato bashkërisht.

Kërkuesit kanë pretenduar se në këto zona, zgjedhjet janë kryer me parregullsi për shkak të dhunës dhe kërcënimit me armë nga banda të armatosura, të cilat kanë futur në kuti të votimit sasi të mëdha fletëvotimesh. Po kështu pretendohet se gjatë numërimit të votave anëtarët e komisioneve janë detyruar me dhunë që të hartojnë procesverbale fiktive.

Për të vërtetuar këto pretendime nga Partia Socialiste, kërkesës i bashkëngjiten disa deklarata të nënshkruara nga nënkryetarët ose ndonjë anëtar socialist të disa qendrave të votimit, ku thuhet se grupe të armatosura kanë dhunuar këto qendra dhe numurimi i votave nuk është bërë në rregull. Këto deklarata janë përpiluar pas përfundimit të procesverbaleve të votimit ndërsa në këto të fundit në asnjë qendër votimi nuk është bërë asnjë vërejtje. Edhe në procesverbalet e komisioneve të zonave nuk ka asnjë vërejtje përse pretendohet.

Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesit nuk provuan pasaktësinë e rezultateve të pasqyruara në procesverbalet e qendrave të votimit.

**PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 e 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29. 4.1991 "Për

dispozitat kryesore kushtetuese", dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", njëzëri,

**V E N D O S I:**

Rrëzimin e kërkesave.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 19.7.1997